

## Rrjeti për Ruajtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik

Projekti NETCET financohet nga Programi IPA Adriatik CBC dhe përfshihet në Prioritetin 2 “Burimet Natyrore dhe Kulturore dhe Parandalimi i Rreziqeve”.

Qëllimi kryesor i këtij programi bashkëpunimi ndërkufitar është forcimi i kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Adriatikut, nëpërmjet një strategjie të përbashkët aktivitetesh midis vendeve partnere të këtij rajoni.

Faqja ëeb e projektit: [www.adriaticipacbc.org](http://www.adriaticipacbc.org)

### SUMMARY

- Përmbledhje e NETCET
- Partneriteti në kuadër të NETCET
- Takimi nismëtar i projektit në Venecia
- Aktivitetet ndërgjegjësuere të NETCET
- Worskhop mbi Qendrat e Shpëtimit, Riccione
- Takimi i partnerëve të NETCET, Losinj

## Përmbledhje e NETCET



Në Detin Adriatik jetojnë disa lloje cetacesh dhe breshkash detare. Individët e rinj të breshkave detare e shfrytëzojnë këtë det si habitat të rëndësishëm ushqimi dhe rritjeje. Fatkeqësisht, cetacetë dhe breshkat detare janë të rrezikuara nga aktivitetet e njeriut, veçanërisht nga peshkimi dhe turizmi bregdetar (si p.sh. ndikimet nga mjetet e lundrimit).

Objektivi kryesor i projektit NETCET është zhvillimi i strategjive të përbashkëta për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik nëpërmjet bashkëpunimit rajonal (bashkëpunimi mbarë-Adriatik). Cetacetë dhe breshkat detare janë trashëgimi natyrore e kërcënuar dhe e përbashkët në rajon, e cila nuk mund të menaxhohet nga një vend i vetëm


që vepron i izoluar. Për shkak të sjelljes migratore të këtyre llojeve dhe përgjegjësi të përbashkëta të vendeve të Adriatikut, bashkëpunimi mes këtyre vendeve ka rëndësi themelore për planifikimin efektiv të strategjive afatgjata të ruajtjes së këtyre llojeve.

Rezultatet kryesore të cilat synohen të arrihen në fund të projektit janë:

- **Njohuri shkencore të standartizuara dhe bashkëpunim efikas** midis organizatave të përfshira në ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik,
- **Kapacitet i rritur institucional për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare** në vendet partnere,
- **Rritje e njohurive mbi ruajtjen e popullatave të cetaceve dhe breshkave detare** të Adriatikut, hot-spotëve dhe kërcënimet kryesore,
- **Kapacitet i rritur teknik për shërimin e breshkave detare në Adriatik** dhe trajtim efikas i breshkave të plagosura në struktura të nivelit të lartë, si dhe rritje e informacionit për publikun në qendrat e shpëtimit,
- **Rritje ndërgjegjëse së komuniteteve bregdetare mbi praninë dhe nevojat e ruajtjes së cetaceve dhe breshkave detare**, si dhe përvetësimi nga peshkatarët i procedurave për trajtimin e duhur të këtyre llojeve,
- Përmirësimi i ruajtjes dhe menaxhimit të cetaceve dhe breshkave detare, si dhe i habitateve të tyre në Adriatik nëpërmjet **bashkëpunimit rajonal efikas**,
- **Kultivimi i sensit të pasurisë** dhe krenarisë për trashëgiminë natyrore të Adriatikut.

Periodha e zbatimit të projektit NETCET: Tetor 2012 - Shtator 2015.

## Partneriteti në kuadër të NETCET



Problemet e ruajtjes së biodiversitetit detar dhe në mënyrë të veçantë çështjet që lidhen me ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare janë të përbashkëta mes të gjithë vendeve të Adriatikut. Nga ana tjetër, përvojat mund të jenë të ndryshme mes rajoneve të ndryshme, prandaj mund të arrihen rezultate mjaft të mira nëse integrohen së bashku praktikatat dhe përvojat më të mira, me qëllim përcaktimin e një kuadri të përbashkët masash dhe mjetesh për ruajtjen e llojeve detare të kërcënuara, duke i bërë këto masa të vlefshme dhe të përdorshme për rajone të tjera. Për këto arsye, projekti NETCET, i koordinuar nga Bashkia e Venecias, zbatohet nga 13 partnerë nga vende të ndryshme të

basenit të Adriatikut: Itali, Kroaci, Shqipëri, Mali i Zi dhe Slloveni.

1. Bashkia e Venecias, Itali.
2. Universiteti i Padovas – Departamenti i Biomjekësisë së Krahasuar dhe Shëndetit Ushqimor, Itali.
3. Bashkia e Peskarës, Itali.
4. Fondacioni Cetacea, Ital
5. Instituti Kombëtar Italian për Kërkim dhe Mbrojtje Mjedisi, Itali.
6. Instituti Shtetëror për Mbrojtjen e Mjedisit, Kroaci.
7. Instituti "Blue World" për Kërkimin dhe Mbrojtjen e Detit, Kroaci.
8. Shoqata e Herpetofaunës Shqiptare, Shqipëri.
9. Shoqata e Mbrojtjes së Gjallesave Ujore të Shqipërisë, Shqipëri.
10. Instituti i Biologjisë Detare, Kotor, Mali i Zi.
11. Universiteti i Primorska, Qendra e Kërkimit Shkencor, Koper, Slloveni.
12. WWF, Itali.
13. Qendra për Edukimin Detar, Pula, Kroaci.

Shoqërues:

Instituti për Mbrojtjen e Natyrës i Republikës së Sllovenisë, Slloveni.

Rajoni Veneto, Itali.

Rajoni Emilia Romanja, Itali.

Rajoni Marke, Italy

## Takimi nismëtar i projektit në Venecia (dhjetor 2012)



Në Dhjetor 2012 në Venecia u zhvillua takimi nismëtar i projektit NETCET, financuar nga Programi IPA Adriatik CBC, për institucionalizimin e Bashkëpunimit Rajonal për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare.

Aktiviteti u hap nga Paola Ravenna, Menaxhere për Politikat Evropiane në Bashkinë e Venecias. Aktiviteti vazhdoi me dy ditë intensive pune, me prezantime dhe shkëmbime interesante profesionale të realizuara në një atmosferë pjesëmarrjeje aktive dhe partneriteti shumë të frutshëm. U trajtuan aspekte të karakterit teknik dhe financiar, me pjesëmarrjen e Sekretariatit të Përbashkët Teknik (JTS) të Programit IPA Adriatik, të cilat u pasuan nga diskutime mbi

përcaktimin e hapave të mëtejshëm të projektit. Një nga çështjet kryesore ku u përqendruan diskutimet ishte ngritja e një databaze të NETCET për cetacetë dhe breshkat detare, lidhja e saj me databazat ekzistuese, si dhe procedurat për monitorimin e cetaceve dhe breshkave detare të dala në brigje.

Ky aktiviteti i shërbeu forcimit të partneritetit mes institucioneve pjesëmarrëse në projekt, të cilët kishin provuar që më përpara bashkëpunimin shumë të mirë në fazën e përgatitjes së projektit. Gjithashtu, ky takim i shërbeu edhe diskutimit të aktiviteteve fillestare trajnuese, si dhe përgatitjes së qendrave të shpëtimit të breshkave detare në nivel lokal.

## Aktivitetet ndërgjegjësuere të NETCET për zvogëlimin e kërcënimeve ndaj breshkave detare dhe cetaceve



Projekti NETCET synon në zvogëlimin e kërcënimeve ndaj popullatave të breshkave detare dhe cetaceve në Detin Adriatik, gje që mund të arrihet, veç të tjerash, edhe duke rritur shkallën e ndërgjegjësimit. Për këtë arsye, NETCET do të ndërmarrë një fushatë të gjerë ndërgjegjësuere me komunitetet dhe grupet që jetojnë dhe frekuentojnë zonat bregdetare në pesë vende të Adriatikut: Itali, Slloveni, Kroaci, Mali i Zi dhe Shqipëri.

Cetacetë dhe breshkat detare janë të kërcënuara nga shumë faktorë, por projekti do të përqendrohet në mënyrë të veçantë në dy prej më të rëndësishmëve në rajon: peshkimi dhe trafiku detar. Peshkimi është veçanërisht i rrezikshëm për


breshkat detare, të cilat ngecin aksidentalisht në mjetet e peshkimit, si në grepa, tratat koçe, mrezha etj. Peshkimi me grepa ushtrohet ndaj peshqve pelagjikë si toni, peshku shpatë etj, duke hedhur ne det me qindra grepa te pajisur me karrem. Breshkat që frekuentojnë Adriatikon (kryesisht *Caretta caretta*) janë mishngrënëse dhe si të tilla tërhiqen nga karremat e grepave, sidomos peshqit dhe kallamarët. Kjo është një nga arsyet për numrin e lartë të breshkave të ngecura në mjetet e peshkimit. Megjithëse breshkat e kapura zakonisht rikthehen të gjalla në det nga peshkatarët, spangot dhe grepat e gëlltitur mund t'u shkaktojnë atyre ngordhjen pas disa orësh ose ditësh. Megjithatë, shumë raste të tilla të ngordhjes mund të shmangen nëse peshkatarët, përpara se të lëshojnë breshkën në det, heqin grepat nga goja e saj, ose presin spangon sa më shkurt që të jetë e mundur. Është provuar që spangot e peshkimit janë shumë të dëmshme, sepse pasi gëlltiten ato çajjnë ose deformojnë zorrët e breshkës, duke i shkakuar ngordhje të ngadaltë dhe të dhimbshme.

Ndërsa breshkat e kapura nga rrjetat fundore (trata koçe) mund të ngordhin nga pamundësia për të dalë në sipërfaqe për frymëmarrje. Këto rrjeta janë si thasë që lëshohen në fund të detit dhe tërhiqen nga anija e peshkimit duke grumbulluar çdo gjë që u del përpara, përfshirë edhe breshkat detare. Meqenëse breshkat marrin frymë në ajër, me mushkëri, ato nuk mund të mbijetojnë gjatë të ngecura në rrjetë, brenda në ujë. Kur peshkatarët zbrazin rrjetat në kuvertën e anijes, breshkat mund të dalin të ngordhura, ose në gjendje kome. Breshkat ne gjendje kome mund të ngordhin nëse hidhen menjëherë në det nga peshkatarët, por mund të shërohen dhe shpëtojnë nëse mbahen për një kohë të shkurtër në kuvertë, derisa të aktivizohen dhe më pas të lëshohen në det.

Siç shihet, me trajtime të thjeshta peshkatarët mund të luajnë rol shumë të rëndësishëm në mbijetesën e breshkave detare. Për këtë arsye, projekti ka planifikuar përfshirjen në aktivitetet e tij të një komuniteti sa më të gjerë peshkatarësh. Me qëllim njohjen e procedurave të thjeshta të shpëtimit të breshkave, do të organizohen takime të posaçme me peshkatarët në vende të ndryshme të Adriatikut, do të shpërndahen postera, bluza dhe materiale të tjera informuese.

Goditjet nga anijet janë një tjetër kërcënim që do të trajtohet në mënyrë të veçantë nga projekti. Goditjet nga paretet e anijeve, ose nga helikat e motorëve mund të vrasin menjëherë cetacetë dhe breshkat detare, ose mund t'u shkaktojnë dëmtime të rënda, shpesh edhe të përherëshme. Megjithëse trafiku detar është një mënyrë transporti e rëndësishme për ekonominë e njeriut dhe nuk është e lehtë për t'u zvogëluar, të paktën përdorimi për argëtim i trafikut detar dhe ngarja me shpejtësi të madhe e varkave apo jahteve sportive mund të kontrollohet më mirë. Projekti, veç të tjerash, ka për qëllim të informojë përdoruesit e anijeve për rreziqet e mundëshme që anijet shkaktojnë tek kafshët detare. Në këtë kuadër, projekti do të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësuere me këtë grup (përdoruesit e anijeve), duke vënë në dukje veç të tjerash edhe rëndësinë për levizjen e kujdesëshme dhe të ngadaltë me anije në zona të caktuara.

Shumë breshka mund të kapen ne det ose në breg nga aktivitetet e njeriut, si peshkimi, trafiku detar etj. Nëse këto kafshë janë akoma në kohën e duhur për t'u lëshuar, ato kanë mundësi të shërohen në qendrat e shpëtimit. Lëshimi në det i breshkave të shëruara mund të jetë një rast i mirë për të ftuar dhe komunikuar me komunitetin lokal dhe turistët, duke i informuar për rreziqet ndaj këtyre kafshëve, si dhe zgjidhjeve të mundëshme. NETCET do të organizojë aktivitete të posaçme për lëshimin e breshkave detare dhe do të shpërndajë informacion në organet e mass-medias, në mënyrë që të informojë një publik sa më të gjerë. Në këtë projekt, një nga grupet kryesore me interes për aktivitete ndërgjegjësimi janë fëmijët. Fëmijët shfaqin shumë interes për kafshët në përgjithësi, si dhe për mbrojtjen e tyre, duke luajtur rolin e "ambasadorit" të kafshëve tek familjet dhe miqtë e tyre. Ata përfaqësojnë brezin e ardhëshëm, i cili mund të luajë rol shumë pozitiv në mbrojtjen e kafshëve. Për këtë arsye, NETCET do të punojë në mënyrë të veçantë me fëmijët e vendeve të Adriatikut, nëpërmjet prezantimeve në shkolla dhe shpërndarjes së materialeve informuese dhe ndërgjegjësuere.



21-23/02/2013

## Worskhop mbi Qendrat e Shpëtimit, Riccione, Itali – Shkurt 2013

Nga 21 në 23 Shkurt 2013, Fondacioni Cetacea priti pjesëmarrës nga disa vende të Adriatikut në një workshop që kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale për trajtimin e duhur të breshkave detare, nëpërmjet një programi të pasur aktivitetesh të mundësuar nga Fondacioni Cetacea, Universiteti i Padovas dhe EEF Itali.



18-21/03/2013

## Takimi i partnerëve të NETCET, Losinj, Kroaci – Mars 2013

Takimi i ardhëshëm i partnerëve të projektit do të zhvillohet në Losinj, Kroaci, në Mars 2013, i cili vijon me një workshop trajnimi intensiv mbi metodat e monitorimit dhe vëzhgimit të cetaceve, me qëllim përgatitjen e pjesëmarrësve në NETCET për vëzhgimet ajrore, fotografimin, markimin me satelit dhe aktivitetet e tjera të ardhëshme të projektit.



The project is co-funded by the European Union  
Instrument for Pre-Accession Assistance



## Contact

City of Venice

✉ [info@netcet.eu](mailto:info@netcet.eu)

Economic Development, European  
Policies and Strategic Plan Division

☎ +39 041 2747826 / 7830 / 7834

San Marco 4136  
30124 Venice - Italy

🏠 [www.netcet.eu](http://www.netcet.eu)f [www.facebook.com/NETCETproject](https://www.facebook.com/NETCETproject)

This Newsletter has been produced with the financial assistance of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme. The contents of this Website are the sole responsibility of the City of Venice and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme Authorities.